



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

---

V E N D I M

Nr.2136, datë 01.08.2012

Për

“Një korrigjim në aktin administrativ normativ: “Rregullore Nr. 14, datë 13. 04. 2010  
“Për dhënien e licences “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC”.

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare  
(**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z.	Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z.	Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.	Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z.	Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj.	Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 01. 08. 2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për një korrigjim në aktin administrativ normativ: “Rregullore Nr. 14, datë 13. 04. 2010 “Për dhënien e licences “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””.

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 120 dhe neni 129 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**KPrA**), i ndryshuar;
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i praktikës dokumentare të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit me përmbajtje si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi projektaktit “Për një korrigjim në aktin administrativ normativ: “Rregulloren për dhënien e licences “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC”” (*Relacioni*);
- Projektakti i propozuar për miratim (*Projektakti*);
- Rregullore Nr. 14, datë 13. 04. 2010 “Për dhënien e licences “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””,

si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

1. Me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, Nr. 121, datë 13. 04. 2010 është miratuar Rregullore Nr. 14, datë 13. 04. 2010 “Për dhënien e licences “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC”” (*Rregullore Nr. 14*).
2. Drejtoria e Licencimit, gjatë praktikës së zbatimit të Rregullores Nr. 14 ka konstatuar se publikimi nga ITU i kodit përkatës AAIC të subjektit FBS Sh.p.k., të licensuar nga AKEP-i si Autoritet i Llogarive detare (ALD) nuk është kryer me Kodin AAIC-AL01 sipas përcaktimit të vendosur nga AKEP-i në përputhje me pikën 3 të nenit 8 të Rregullores Nr. 14, por AAIC-AB01.
3. Mospërputhja e cituar në pikën 2 të mësipërve vjen për shkak se ITU publikimi e Kodit AAIC për Shqipërinë e bën duke përdorur emërtesën e shkurtuar për Shqipërinë – AB dhe jo AL siç njihet zakonisht ndërkombëtarisht dhe siç është vendosur në pikën 3 të nenit 8 të Rregullores Nr. 14. Kjo mospërputhje ka ardhur për arsye të një gabimi nga grupi i punës gjatë përgatitjes së projektaktit administrativ normativ, duke mos qenë në dijeni të këtij fakti gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të tij.
4. Për të eliminuar këtë pasaktësi të dukshme të aktit, duke patur parasysh përcaktimet e parashikuara në nenin 120 të KPrA, mund të kryhet korrigjimi i kësaj pasaktësie në pikë 3 të nenit 8 të Rregullores Nr. 14, sipas procedurës ligjore të parashikuar në nenin 129 të këtij Kodi.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918, pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme, në zbatim të nenit 129 të KPrA, me qëllim korrigjin e pasaktësisë së konstatuar në pikën 3 të nenit 8 të Rregullores Nr. 14,

## V E N D O S :

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

[www.akep.al](http://www.akep.al)

Fax : + 355 4 2259 106

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

1. Të miratojë korigjin e pikës 3 të nenit 8 të Rregullores Nr. 14, datë 13. 04. 2010 “Për dhënien e licences “Autoritet i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””, si më poshtë:

“3. *AAIC për Shqipërinë do të ketë formatin si më poshtë:*

*ABX<sub>1</sub>X<sub>2</sub> - Dy gërmat e para AL identifikjnë Shqipërinë, ku X<sub>1</sub> dhe X<sub>2</sub> është çdo numur nga 0 në 9.*

*Për shembull: AB01, AB02...AB99”.*

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**